



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ____ . ____ . 2020

[03.12.2020]
FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT
BASHKIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË

“EKSKLUZIV” “& “JUBICA”& “MELA”
Lezhe Rreshen RRESHEN Fierze, Mirdite, Zona Kadastrale 1618, Pasuria Nr. 103/6.

Procedura e prokurimit: Pune/ Procedure e Hapur

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-75535-10-14-2020

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Stabilizim i rreshqitjeve ne segmentin rrugor Milot-Rreshen, rruga e vjeter”, me fondin limit 78.910.092,18 lekë (pa përfshirë vlerën e TVSH-së, REF-75535-10-14-2020, Afati i kontrates 4 muaj e 10 dite

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve 19 Tetor 2020 [Nr.89]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët X

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. “SIRETA 2F” & ”EURO – ALB” & ”NET – GROUP”

NUIS: K51501008J / K66613407H / L72023002P

Vlera: 44.000.000 (dyzete e kater milion) Leke

2. “EKSKLUZIV” & “JUBICA” & “MELA”

NUIS J69102021W / K26529001I / K62320011G



Vlera: 77.313.820 (shtatedhjetë e shtatë milion e treqind e trembedhjetë mijë e teteqind e njëzete) Leke

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. Bashkimi i Operatoreve Ekonomike **”SIRETA 2F” & ”EURO – ALB” & ”NET – GROUP”**, nuk kualifikohet pasi nuk plotëson kriteret e percaktuara në Dokumentat Standarte të Tenderit. **Arsyet e skualifikimit si më poshtë:**

*1. Deklaratë mbi disponueshmërinë e mjeteve sipas Shtojcës 10; Ka deklaruar se :
Mjetet dhe paisjet e propozuara nga shoqëria “SIRETA 2F” shpk, për procedurën e prokurimit me objekt: “Stabilizim i rreshqitjeve në segmentin rrugor Milot- Rreshen, rruga e vjetër”, janë të angazhuara vetëm në këto kontrata, nuk janë të deklaruara në procedurën e tjera, nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera si dhe nuk janë të deklaruara në procedurën e shpallur fitues nga autoriteti juaj kontraktor.
Për nga verifikimet e kryera rezultojnë se :*

Disa nga mjetet e paraqitura në këtë tender rezultojnë të deklaruara dhe në përdorim në kontratën “Rikonstruksion i Urës së Dragotit” kontratë e cila akoma nuk ka përfunduar, dhe konkretisht mjetet me targë :

- | | |
|-----------------------------|-------------------------------------|
| - AA 698 MZ (Autovinç) | - AG MT 61 (Eskavator) |
| - AA711HJ (Kamion Iveko) | - Asfaltoshtruese (Antonella VFA44) |
| - AA 735 PY (Autovinç) | - Eskavator (Liheberr) |
| - AA 794 CP (Autobetoniere) | - Minieskavator (Volvo 1.4) |
| - AA 798 CP (Autovinç) | - Rrul me goma (Bomag) |
| - AA MT 14 (JCB) | - Rrul (Caterpillar) |

Gjithashtu mjetet e paraqitura nga Shoqëria “Sireta 2F” shpk, të marra me qera nga shoqëria “IBN” shpk, nuk janë të vlefshme pasi dhënia e tyre me qera është në kundërshtim me përcaktimet në nenin 81, pika 1,2,3,4,5 dhe 7,8 “Destinacioni dhe Përdorimi i Mjeteve” i ligjit nr.8378 datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenin 3, paragrafi 3.13 dhe 3.14 të Ligjit nr.8308, datë 18.3.1998 për “Transportet rrugore”, si dhe në nenin 41, të Ligjit nr.8308, datë 18.3.1998 për “Transportet rrugore”, ku parashikohet se: “Transporti i mallrave me qira dhe për të tretë është i ndaluar të kryhet pa licencën përkatëse”. Sa më sipër cituar operatori ekonomik nuk e përmbush kriterin e përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit.



2 Deklarate mbi kontratat e lidhura apo ne proces, sipas Shtojcës 11; Ka deklaruar se : Shoqeria “SIRETA 2F” Sh.p.k me nr. Nipt K51501008J, per objektin: “Stabilizim i rreshqitjeve ne segmentin rrugor Milot- Rreshen, rruga e vjeter”, deklaroi nen pergjegjesine time qe brenda së njëjtës periudhë nuk jemi kontraktor/nënkontraktor për kontratë/kontrata të lidhura, me vlerë të përbashkët ose të veçantë, jo më të madhe se 100 % i kufirit maksimal, që disponon shoqeria, sipas licencës profesionale, të lëshuar nga autoriteti kompetent. Në kuptim të përcaktimit të mësipërm, fjala “periudhë” nënkupton kohëzgjatjen e investimit të kryer sipas LPP-së nga çasti i shpalljes fitues e deri në kolaudimin e objektit/investimit.

Por nga verifikimet e kryera rezulton se :

Operatori ekonomik “Sireta 2F rezulton se ka lidhur kontrate me Autoritetin Rrugor Shqiptar për objektin “Rikonstruksion i Urës së Dragotit” kontratë e cila është në zbatim e sipër (nuk ka përfunduar).

3 Lidhur me kapacitetet teknike pune e ngjashme pika 2.3.1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 2.3.1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Operatori ekonomik “Euro Alb” shpk nuk plotëson kriterin e vënë në dokumentat standarte të tenderit duke mos paraqitur punë të ngjashme me atë të kërkuar në tender.

Gjithashtu operatori ekonomik “NET GROUP” shpk nuk plotëson kriterin e vënë në dokumentat standarte të tenderit duke mos paraqitur punë të ngjashme me atë të kërkuar në tender.

4.Referuar kontratës së bashkëpunimit mes tri shoqërive rezulton që punimet janë ndarë në masën; “Sireta 2F” shpk 75.73%, “Euro Alb” shpk 22% dhe “Net Grup” shpk 2.27%. Në nenin 74, pika 1 dhe 2 të, VKM-se, 914/2014, parashikohet se : “1. Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe në rast përzgjedhjeje edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi..... 2. Para dorëzimit të ofertës, bashkimi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit/furnizimit dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Në rastin konkret nuk janë përcaktuar elementet konkrete në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik dhe kriteret e dhëna në dokumentet e tenderit.



Për stafin e mësipërm të paraqiten:

- Kontratë individuale të punës
- Diploma/certifikata
- Deshmi kualifikimi te sigurimit teknik
- Të figurojnë në listëpagesën e shoqërisë për periudhën e përcaktuar si staf i shoqërisë

5. Lidhur me stafin e paraqitur nga bashkimi i operatoreve Për të plotësuar këtë kriter nga BOE "Sireta 2F shpk & Euro Alb shpk & Net Group shpk", janë dorëzuar liçencat përkatëse të shoqërive. Nga kontrolli i tyre repektivisht rezulton që :

1. Operatori "Sireta 2F" shpk midis të tjerëve rezulton të ketë si drejtues teknik të shoqërisë :

- **Erda Kola**, drejtues teknik si Inxhinier mjedisi – trajtim ujërash, subjekt i cili rezulton të jetë i punësuar me kohë të plotë pranë Ujësjellës Kanalizime, Tiranë.
- **Leonard Grabova**, drejtues teknik si Inxhinier Gjeodet, subjekt i cili rezulton të jetë i punësuar me kohë të plotë pranë Drejtorisë Vendore të ASHK-së, Tiranë.

Në kreun III “Kategorizimi dhe klasifikimi i licencës, elementët e saj, kushtet, kriteret dhe kufizimet”, pika 2 dhe pika 3 gërma “a”, paragrafi 2 të VKM Nr.42, datë 16.1.2008 “parashikohet se : 2. Elementet e licencës: a) Licenca përmban këto elemente: I. Kategoritë e punimeve të ndërtimit (përcaktuar në lidhjen nr.2); II. Klasifikimin me nivele për çdo kategori (përcaktuar në lidhjen nr.4); III.Numrin e identifikimit; IV.Datën e regjistrimit në Regjistrin Themeltar (e njëjtë me datën e marrjes së vendimit nga komisioni); V. **Emrat e drejtuesve ligjorë e teknikë**; VI. Selinë; VII. Afatin e vlefshmërisë; VIII.Elementet e sigurisë të përcaktuara me urdhër të ministrit; IX.Të dhënat e plota të kategorive dhe klasifikimit, në pjesën e pasme të licencës (Lidhjet 2 e 4 të kësaj rregulloreje). ”[...] Në kreun I “Qëllimi, fusha e veprimit të rregullores dhe përkufizime” pika 2 të VKM Nr.42, datë 16.1.2008 “parashikohet se:

“Drejtues teknik”- individi/ët e diplomuar në degët përkatëse të universitetit që është/janë përgjegjës/a për ndërtimin e objekteve sipas projektit dhe në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës.



Kreu III, pika 3/c, ku thuhet c) *Licencat e shoqërive jepen me afat të njëjtë me atë për të cilin janë regjistruar për të ushtruar veprimtari në QKR apo gjykatë. **Ndalohet ushtrimi i veprimtarisë zbatuese në ndërtim në mungesë të drejtuesit/ve teknikë të shoqërisë. Shoqëritë e licencura jo më vonë se 10 ditë kalendarike, kur drejtuesi teknik është dorëhequr ose ka pamundësi fizike për ushtrimin e detyrës (aksident, sëmundje me paaftësi ushtrimi detyre mbi 14 ditë, invaliditet, ndarje nga jeta), kanë detyrimin të paraqesin njoftim së bashku me kërkesën për drejtuesin e ri teknik të shoqërisë.***

Si rregull përgjegjësitë e drejtuesit teknik të shoqërisë për këtë periudhë (nga kontraktimi deri në shqyrtimin e kërkesës) mbulohen nga drejtuesi i ri i kontraktuar deri në vendimmarrjen e komisionit. Kur komisioni vendos mospranim të kërkesës ose në mungesë të dokumentacionit të plotë sekretariati teknik dërgon njoftim për plotësim dokumentacioni, sipas paragrafit VI, shkronja “a”, pika 4 e kreut II të kësaj rregulloreje, shoqëria detyrohet të pezullojë punimet menjëherë deri në licencimin sipas rregullave dhe procedurave të caktuara në këtë rregullore. [...]

Kreu IV, “**Drejtuesi teknik i shoqërisë dhe papajtueshmëria me këtë detyrë**” pika 2, përcakton:

*Drejtuesit teknikë të shoqërisë nuk mund të jenë personat që **janë të angazhuar në çdo punëmarrje tjetër publike.***

*Drejtuesi teknik i shoqërisë **nuk mund të jetë njëkohësisht i punësuar në dy apo më shumë shoqëri ndërtimi** dhe ndalohet të disponojnë licencë për mbikëqyrje e kolaudim të punimeve të zbatimit. [...]*

Ne vijim kreu VII përcakton se 1/a “*Heqja e së drejtës për ushtrimin e aktivitetit ose pezullimin e përkohshëm në zbatim, për periudha të ndryshme të shoqërive apo kategori të drejtuesve teknikë të shoqërive, në rastet kur: I. Konstatohen ose **provohen deklarime (sipas parashikimeve në këtë rregullore) të rreme, dokumente të pavërteta të subjektit deklarues. Në këtë rast komisioni heq licencën për një periudhë 5 vjet. II. Shoqëria kryen veprimtari pa drejtues teknik ose shkel afatet e njoftimit të caktuara në këtë rregullore. Në këtë rast komisioni heq licencën për shoqërinë/drejtuesit për një periudhë 3 vjet.***

Licenca e paraqitur nga operatori ekonomik “Sireta 2F” shpk, megjithëse është lëshuar nga Institucioni përgjegjës **shfaq të meta dhe nuk përmbush detyrimet ligjore të parashikuara nga akti normativ në zbatim të ligjit, VKM Nr.42**, datë 16.1.2008 “Për miratimin e Rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, për shkak të punësimit të drejtuesve teknikë në punëmarrje publike ose shoqëri të tjera ndërtimi.



Referuar pikës 5 gërmës (a) dhe (b) të Kreut II të VKM nr 42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, është detyrim ligjor i çdo **subjekt të licencuar** në zbatim që të aplikojë për përditësimin e të dhënave.

6.Operatori/et ekonomik duhet të kenë në stafin e tyre personel të kualifikuar/çertifikuar si:

- Operatori ekonomik duhet të disponojë të paktën 20 punonjës të certifikuar me deshmi te sigurimit teknik lëshuar nga ISHTI ose ekuivalente, në përputhje me zërat e punimeve në preventiv. Ndermjet tyre, dhe specialistet e meposhtem:
- 2 (dy) mekanike vërtetuar me kontratë pune të vlefshme si edhe të pajisur me Certifikatë/dëshmi/diploma përkatëse të kualifikimit Profesional lëshuar nga shkolla të mesme profesionale ose institucione jopublike, të akredituara në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- 3 (tre) specialistë ndertimi, vërtetuar me kontratë pune të vlefshme si edhe të pajisur me Certifikatë/dëshmi/diploma përkatëse të kualifikimit Profesional lëshuar nga shkolla të mesme profesionale ose institucione jopublike, të akredituara në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- 2 (dy) Teknik ndërtimi, vërtetuar me kontratë pune të vlefshme si edhe të pajisur me Certifikatë /dëshmi /diploma përkatëse të kualifikimit Profesional lëshuar nga shkolla të mesme profesionale ose institucione jopublike, të akredituara në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Për secilin duhet të paraqiten:

- Kontratë individuale të punës
- Diplomë ose certifikate
- Të figurojnë në listëpagesën e shoqërisë për periudhen **Prill 2020 – Shtator 2020**

Operatori ekonomik “Sireta 2F” shpk nuk ka paraqitur teknik ndërtimi. Personat e paraqitur prej tij si teknik ndërtimi janë :

- Sali Laçi vërtetim për kurs 32 orë për teknik.
- Amarildo Xhoka diplomë bachelor (ing.ndërtimi) e vitit 2019, ska eksperiencë.
- Kurtish Kaloshi teknik H/Teknik, ka vetëm një licensë për teknik Hidro.



7. Nuk ploteson kriterin sipas pikes 2.3.4 *Operatori Ekonomik duhet te deklaroje me shkrim se inxhinieret dhe punonjesit e kerkuar ne piken 2.3.3 per kualifikim jane te paangazhuar ne kontrata te tjera.*

Ndërkohë Operatori ekonomik “Sireta 2F” shpk Ing. Bledi Shehu, Ing. Leonard Grabova dhe tekniku Shpëtim Gjyzeli, i ka të angazhuar në kontratën “Rikonstruksion i Urës së Dragotit” kontratë e cila nuk ka përfunduar akoma.

8. Nuk permbush kriterin sipas pikes 2.3.7 Operatori Ekonomik duhet te kete ne përbërje te stafit punonjësit ne përputhje te plote me VKM nr. 632, date 15.07.2015, i ndryshuar.

Operatori Ekonomik duhet te kete ne perberje te stafit Nje Mjek ne perputhje te plote me VKM nr.108 date 09.02.2011, i ndryshuar, te vertetuar me kontrate pune te vlefshme, diplome CV, leje ushtrimi profesioni te leshuar nga Urdheri i Mjekut.

Operatori ekonomik “Sireta 2F” shpk ka paraqitur si mjeke me kohë të plotë dr. Lluiza Kolasi e cila në CV-në e saj deklaron se punon në disa kompani ndërtimi.

Nuk ploteson kriterin sipas pikes 2.3.10 Operatori ekonomik duhet te disponoje mjetet dhe paisjet e nevojshme teknike per realizimin e kontrates. *Per kete duhet te paraqese deshmi per mjetet dhe paisjet teknike qe ka ne dispozicion apo mund t'i vihen ne dispozicion operatorit ekonomik.*

a) Per mjetet qe transportojne mallra te rrezikshem duhet te paraqitet certifikat perkatese e leshuar nga institucioni kompetent.

Operatori/et ekonomik ofertues duhet te deklaroje qe te gjitha mjetet dhe pajisjet e pershkruara ne piken 2.3.10 te Kapacitetit Teknik do te jene te angazhuara vetem ne kete kontrate. Mjetet te cilat rezultojne te angazhuara ne kontrata te tjera afati i zbatimit te cilave shtrihet pergjate afatit te kontrates objekt i prokurimit jane shkak skualifikimi.

9.Nuk ploteson kriterin sipas pikes 2.3.11 Makinerite e mesiperme nuk duhet te jene te angazhuara ne kontrata te tjera. Per kete te paraqitet nje deklarate nga administratori i shoqerise ofertuese se makinerite e mesiperme nuk jane te angazhuara ne kontrata te tjera.

Mjetet e marra me qera të paraqitura nga Shoqëria “Sireta 2F” shpk, nga shoqëria “IBN” shpk, nuk janë të vlefshme pasi dhënia e tyre me qera është në kundërshtim me përcaktimet në nenin 81, pika 1,2,3,4,5 dhe 7,8 “Destinacioni dhe Përdorimi i Mjeteve” i ligjit nr.8378



datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenin 3, paragrafi 3.13 dhe 3.14 të Ligjit nr.8308, datë 18.3.1998 për “Transportet rrugore”, si dhe në nenin 41, të Ligjit nr.8308, datë 18.3.1998 për “Transportet rrugore”, ku parashikohet se: “Transporti i mallrave me qira dhe për të tretë është i ndaluar të kryhet pa liçencën përkatëse. Sa më sipër cituar operatori ekonomik nuk e përmbush kriterin e përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit.

Përvec kësaj mjetet e paraqitura në këtë tender (ku Kompania “Sireta 2F” deklaron se nuk i ka të angazhuara në asnjë kontratë tjetër rezultojnë të deklaruara dhe në përdorim në kontratën “Rikonstruksion i Urës së Dragotit” kontratë e cila akoma nuk ka përfunduar, dhe konkretisht mjetet me targë :

- | | |
|-----------------------------|-------------------------------------|
| - AA 698 MZ (Autovinç) | - AG MT 61 (Eskavator) |
| - AA711HJ (Kamion Iveko) | - Asfaltoshtruese (Antonella VFA44) |
| - AA 735 PY (Autovinç) | - Eskavator (Liheberr) |
| - AA 794 CP (Autobetoniere) | - Minieskavator (Volvo 1.4) |
| - AA 798 CP (Autovinç) | - Rrul me goma (Bomag) |
| - AA MT 14 (JCB) | - Rrul (Caterpillar) |

10. Nuk ploteson kriterin sipas pikes 2.3.13 Operatori ekonomik duhet te disponoje kontrate bashkëpunimi me nje laborator te akredituar ne vendin tone per testimin e materialeve te ndërtimit ne përputhje me S SH / IEC 17025:2006, e vërtetuar me certifikatat e akreditimit nga organizmat akreditues, konkretisht netestet e meposhtme:

Laboratori i paraqitur si pjesë e kryerjes së shërbimeve të kërkuara në dokumentet e tenderit nuk rezulton që të jetë i akredituar në vendin tonë për testimin e materialeve të ndërtimit në përputhje me S SH / IEC 17025:2006, e vërtetuar me certifikatat e akreditimit nga organizmat akreditues, konkretisht në testet e mëposhtme:

- Përcaktimi i forcës në shtypje e mostrave të testimit
- Prova për shkatërrimin e mostrës, metodika e kryerjes së provave pa shkatërrim të betonit,
- Përcaktimi i shpejtësisë së impulsit ultrasonik
- Përcaktimi i karakteristikave të boshllëqeve të mostrave bituminoze
- Përcaktimi i trashësisë së saj,
- Temperatura,
- Kontrolli i përmasave të hekurit
- Rezistenca e tërheqjes së tij
- Përcaktimi i modulit të deformimit
- Metodika e kryerjes së provave pa shkatërrim të shtresave rrugore,



- Metoda e përcaktimit të deformimeve,
- Karakteristikat e sipërfaqes së rrugëve etj.

Laboratori ka afat për akreditimin (për provat e tjera) deri më 11.05.2021 por nuk është rishikuar më që nga 31.07.2018.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë bashkimin e operatoreve ekonomik “EKSKLUZIV” “& “JUBICA”& “MELA” , me adrese **Lezhe Rreshen Fierze, Mirdite, Zona Kadastrale 1618, Pasuria Nr. 103/6**, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **77.313.820 (shtatedhjetë e shtate milion e treqind e trembedhjetë mijë e teteqind e njezete)** lekë, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Autoriteti Rrugor Shqiptar, Adresa rruga “Sami Frashëri nr.33”, Tiranë, Tel/Fax +355 4 223448, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [] siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 25.11.2020

Ankesa : Ankesa JO.

Konceptoi: M. Shkurti

Miratoi: V.Hodaj

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Ergys Verdho

